Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/438
Datë: 02.07.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" me adresë: Kampusi Inovativ në Lipjan, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2024 deri 31.08.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Bashkëpuntor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor në 4 (katër) klasë me nga 25 (njëzetepesë) nxënës për cikel. Numri i nxënësve në ushtrimet praktike në shkollë për këtë kualifikim të jetë i ndarë në 2 (dy) grupe me nga 12 (dymbëdhjetë) ose 13 (trembëdhjetë) nxënës për secilen klasë, ndërsa në praktikë në institucionet e kujdesit shëndetësor nga 3 (tre) grupe me nga 8 (tetë) dhe 9 (nëntë) nxënës për secilën klasë. Numri total i nxënësve për një cikël të jetë 100 (njëqind) nxënës.

   1.2 **Asistent Dentar,** Niveli IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C) dhe Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me 25 (njëzetepesë) nxënës brenda një klase dhe gjatë 1 (një) viti mund të mbahen deri në 6 (gjashtë) paralele.

2. **Riakreditohet dhe rivalidohet** me Kusht Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" me adresë: Kampusi Inovativ në Lipjan, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2024 deri 31.08.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

2.1 **Teknik i Farmacisë**, Niveli IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C) dhe Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor në 3 (tre) grupe për sa i përket pjesës së mësimit teorik, përgjatë gjithë semestrit, me nga 25 (njezetepesë) kandidatë/nxënës për një grup në orët e mësimit teorik, ndërsa për mësimin laboratorik mund të përfshihen 8 (tetë) nxënës në një grup.

2.2 Institucioni është riakreditуar dhe rivaliduar për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimit Teknik i Farmacisë niveli IV i KKK me kushtet si më posht:

- Institucioni duhet të sigurojë pajisje dhe instrumente shtesë brenda hapsirave ekzistuese të cilat janë të nevojshme për realizimin e mësimit praktik nga fushat profesionale farmaceutike, si: farmacia galenike, farmakognozia, kimia farmaceutike etj.
- Institucioni duhet të sigurij mjedise të përshtatshme ku nxënësit do të zhvillojnë shkathtësitë e përgatitjes së formave të ndryshme të dozimit farmaceutik, përfshirë paketimin, ruajtjen, sigurimin e cilësisë dhe dispensimin e tyre.

2.3 Institucioni obligohet të plotësoj kushtet si më lart deri me datë 01.03.2025.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" me datë 13.12.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimet: Bashkëpuntor Profesional i Infermierisë, niveli III dhe IV i KKK, Asistent Dentar, niveli IV i KKK, Teknik Farmacisë, niveli IV i KKK dhe Teknik i Laboratorit, niveli III dhe IV i KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë 30.04.2024 kanë realizuar vizitën në Kolegjin Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT", ndërsa me datë 27 dhe 28 maj 2024 kanë përpiluar raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet për të cilat institucioni ka parashtruar kërkesë për riakreditim dhe rivalidim. Raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 24.06.2024.
Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar tek pala aplikuese. Ekipi i ekspertëve në raportin vlerësues për

kualifikimin Teknik i Farmacisë, niveli IV i KKK, bazuar në të gjeturat në dosjen e aplikimit dhe nga konstatimet me rastin e realizimi të vizitës tek Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" kanë rekomanduar që institucioni të riakreditohet me kushtet si paragrafin 2 pika 2.2 e këtij vendimi me kusht që të njëjtat të plotësohen deri me datë 01.03.2025.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" për riakreditim dhe rivalidim, rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT"
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së